

VENDIM
Nr.736, datë 29.9.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO STAR”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Star”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge, me zonë licencimi qytetin e Fierit.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 2.5.2008 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)